

Marrëveshja e Financimit BNK për Programet Vjetore IPA II Kushtet e Veçanta versioni 1.2(Shtator 2018)

MARRËVESHJE FINANCIMI KUSHTET E VEÇANTA

Komisioni Evropian, në vijim i referuar si "**Komisioni**" ose "pala" e cila vepron në emër të Bashkimit Evropian, në vijim i referuar si "Bashkimi",

nga njëra anë dhe

Republika e Maqedonisë së Veriut, e përfaqësuar nga Sekretariati për Çështjet Evropiane dhe Republika e Shqipërisë e përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, në vijim të referuar bashkërisht si "**Përfituesit e IPA II**" ose individualisht si "përfituesja e IPA II" ose "pala",

nga ana tjetër,

dhe bashkërisht të referuara si "Palët"

Ku,

Çdo referencë e përfshirë në këtë marrëveshje dhe në anekset e tij me "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë" duhet të lexohet "Republika e Maqedonisë së Veriut"

KANË RËNË DAKORD SI MË POSHTË:

Neni 1- Programi i Veprimit

1. Bashkimi bie dakord të financojë dhe përfituesit e IPA II bien dakord të pranojnë financimin e lëvrimit për vitin 2018 të Programit të Veprimit në vijim, siç përshkruhet në Shtojcën I:

“Programi i Veprimit të Bashkëpunimit Ndërkufitar ndërmjet ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë për vitet 2018-2020”

Numri global i zotimit (CRIS) /2018/041-370

Ky Program Veprimi financohet nga Buxheti i Bashkimit në bazë të aktit themelor në vijim: Instrumenti për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA II)¹.

¹ Rregullorja Nr. 231/2014 (BE) e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 mars 2014 që krijon një Instrument për Ndihmën e Para-Anëtarësimit (IPA II), OJ L 77, 15.03.2014, fq. 11.

Marrëveshja e Financimit BNK për Programet Vjetore IPA II Kushtet e Veçanta versioni 1.2(Shtator 2018)

2. Kostoja e përgjithshme e vlerësuar e lëvrimit për vitin 2018 të këtij Program Veprimi është 2,000,000 Euro dhe kontributi maksimal i Bashkimit për këtë Program Veprimi është caktuar në 1,700,000 Euro.

Nuk kërkohet kontribut financiar nga përfituesit e IPA II.

Neni 2- Periudha e ekzekutimit dhe periudha e zbatimit operacional

- (1) Siç përcaktohet në nenin 1 (1) të Shtojcës II, periudha e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje Financimi është caktuar 12 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi.
- (2) Siç përcaktohet në nenin 1 (2) të Shtojcës II, periudha e zbatimit operacional të kësaj Marrëveshjeje Financimi është caktuar 6 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

Neni 3- Adresat dhe Komunikimi

I gjithë komunikimi në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshjeje financimi duhet të jenë në formë të shkruar dhe do ti referohet shprehimisht Programit të Veprimit siç identifikohet në nenin 1 (1), dhe do të dërgohet në adresat e mëposhtme:

a) për Komisionin

Znj. Genoveva Ruiz Calavera
Drejtorja D, Ballkani Perëndimor
Drejtoria e Përgjithshme për Negociatat e Zgjerimit dhe
Fqinjësinë, Komisioni Europian
15, Rue de la Loi, B – 1049 Bruksel, Belgjikë
E-mail: NEAR-D1@ec.europa.eu

b) për përfituesit e IPA II

Për Republikën e Maqedonisë së Veriut:
Sekretariati për Çështjet Evropiane,
Quai Dimitar Vlahov No.4,
1000 Shkup, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë,
Tel: +389 (0)2 3200 105, Faks: +389(0)2 3114 569,
e-mail: cabinet@sep.gov.mk

Për Republikën e Shqipërisë:
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Drejtoria e Fondeve të BE-së

Marrëveshja e Financimit BNK për Programet Vjetore IPA II Kushtet e Veçanta versioni 1.2(Shtator 2018)

Bulevardi “Gjergj Fishta” No. 6
Tiranë, Republika e Shqipërisë
e-mail: info@mfa.gov.al

Neni 4- Pikat e kontaktit të Zyrës Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF)

Pika e kontaktit të përfituesit të IPA II që ka kompetencat e duhura për të bashkëpunuar drejtpërdrejt me Zyrën Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF), në mënyrë që të lehtësojë aktivitetet operative të OLAF-it, do të jenë:

Z. Fatmir Ademi, Shefi i Departamentit për Inspektimin Financiar të Sektorit Publik dhe Koordinimin për Luftimin e Mashtrimit kundër Fondeve të BE-së, Quai Dimitar Vlahov Nr.4, kati 4, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, e-mail: fatmir.ademi@finance.gov.mk

Dhe,

Z. Bejko Late, Drejtor i Sektorit të Inspektimit Financiar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë të Shqipërisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë, Shqipëri, email: Bejko.late@financa.gov.al

Neni 5- Marrëveshjet Kuadër

Programi i Veprimit do të zbatohet në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Komisionit Evropian dhe ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë mbi marrëveshjet për zbatimin e ndihmës financiare të Bashkimit për ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë nën Instrumentin e Ndihmës së Para-Anëtarësimit (IPA II), e cila ka hyrë në fuqi më 24 qershor 2015 dhe në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Komisionit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi marrëveshjet për zbatimin e ndihmës financiare të Bashkimit në Shqipëri nën Instrumentin e ndihmës së Para-Anëtarësimit (IPA II) që ka hyrë në fuqi më 16 prill 2015, (referuar në vijim si "Marrëveshja/jet Kuadër").

Kjo Marrëveshje Financimi plotëson dispozitat e Marrëveshjeve Kuadër të lartpërmendura. Në rast konflikti, nga njëra anë, e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje financimi dhe, nga ana tjetër, dispozitave të Marrëveshjes Kuadër përkatëse, kjo e fundit do të ketë përparësi.

Neni 6- Shtojcat

1. Kjo Marrëveshje Financimi përbëhet nga:
 - a) këto Kushte të Veçanta;
 - b) Shtojca I: “Programi i Veprimit të BNK-së, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Republika e Shqipërisë për vitet 2018-2020”;
 - c) Shtojca IA: IPA II CBC 2014-2020 Programi ndërmjet ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë;

Marrëveshja e Financimit BNK për Programet Vjetore IPA II Kushtet e Veçanta versioni 1.2(Shtator 2018)

- d) Shtojca II: Kushtet e Përgjithshme;
- e) Shtojca III: Raporti Vjetor Model CBC për zbatimin e ndihmës IPA II në përputhje me nenin 80 të Marrëveshjes Kuadër;
- f) Shtojca IIIA: Raporti Vjetor Tip për zbatimin e ndihmës IPA II në përputhje me nenin 58 të Marrëveshjes Kuadër;
2. Në rast të një konflikti, nga njëra anë, të dispozitave të Shtojcave dhe nga ana tjetër, të dispozitave të këtyre Kushteve të Veçanta, këto të fundit do të kenë përparësi. Në rast të një konflikti, nga njëra anë, të dispozitave të Shtojcës I dhe Shtojcës IA dhe dispozitave të Shtojcës II nga ana tjetër, këto të fundit do të kenë përparësi. Në rast konflikti ndërmjet dispozitave të Shtojcës I, nga njëra anë dhe dispozitave të Shtojcës IA nga ana tjetër, këto të fundit do të kenë përparësi.

Neni 7- Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Financimi do të hyjë në fuqi ditën që do të nënshkruhet nga pala e fundit, jo më vonë se 31 Dhjetor 2019.

Kjo marrëveshje hartohet në gjuhën angleze në tri kopje, një kopje i dorëzohet Komisionit dhe një kopje secilit prej përfituesve të IPA II.

Për përfituesit e IPA II:

Për Komisionin:

Për Republikën e Maqedonisë së Veriut:

Bujar Osmani,

Genoveva Ruiz Calavera

Zëvendës Kryeministër për Çështjet Evropiane
dhe Koordinator i Kombëtar i IPA-s

Drejtor pranë Drejtorisë së Përgjithshme, Drejtoria
D,

Shkup

Datë:

Bruksel

Për Shqipërinë:

Datë:

Z. Sokol Dedja
Zëvendësministër për Evropën dhe Punët e
Jashtme
Koordinatori Kombëtar i IPA-s

Tiranë

Datë: